



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA QENDRORE

Nr. 744/15 prot.

Tiranë, më 28.04 2026

Lënda: Shpallje për subjektin:

“ALBALKA GROUP” ME NIPT M21829038R

Rruga “Marije Kraja” Njesia Admin.nr.3, Ap.nr.6, kati 2.

Tiranë

Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Qëndrore, ka kryer inspektim në subjektin “ALBALKA GROUP” me nipt M21829038R dhe adresë Rruga “Marije Kraja” Njesi Admin. nr.3, Ap.nr.6, kati 2. si dhe me adresë të dytë të padeklaruar: Zogu i Zi, Pallati Katar, kati 6., Ap.23. Gjatë procesit të inspektimit bazuar në ligjin nr.99, datë 12.09.2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", është mbajtur procesverbali i inspektimit me Nr. ISHPSHSH-DQ-2026-000030-2, datë 17.04.2026.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji nr.99, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë", njoftimi i subjektit për procesverbalin e inspektimit nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë në adresën ku subjekti ushtron aktivitet, adresa e deklaruar në ekstraktin e QKB-së. Objekti postar është kthyer mbrapsht nga të dy adresat me shënimet: “Objekt i pa kërkuar” (me pushime) dhe “Adresë e pamjaftueshme” (nuk pergjigjet në telefon).

Bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodi Procedurës Administrative, Drejtoria Qendrore e ISHPSHSH-së ka vendosur, njoftimin e subjektit “ALBALKA GROUP” me nipt M21829038R dhe adresë Rruga “Marije Kraja” Njesia Admin.nr.3, Ap.nr.6, kati 2 për njohjen me procesverbalin e inspektimit me anë të shpalljes dhe njoftimit duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së, në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim, QKB dhe në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të web.


Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes. Kundër Procesverbalit të Inspektimit subjekti “ALBALKA GROUP”, mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose gojë, pranë inspektoratit shtetëror, brenda 8 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit.

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Procesverbalit të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë Drejtorisë Qendrore të ISHPSHSH-së, me adresë Rr. “Sheh Ahmet Pazari”, nr.10, Tiranë.

Ky njoftim shpallet sot më datë 28.04.2026 dhe qëndron i afishuar deri në datë 08.05.2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYEINSPEKTORI
Eljo Muçaj

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "E-REPUBLIKA SHQIPTARE" at the top, "KRYEINSPEKTORI" in the center, and "DHE INOVACION" at the bottom. The signature is a stylized, cursive script.